



## Permbledhje joteknike e aktiviteteteve

### “Stacion i depozitimit dhe tregtimit te GLN”

*ID 1.7 Gaz natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave.*



**Subjekti:** “Bena-Gas” Sh.p.k

**Hartoi:** “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

**Administrator:** Shkelzen MADANI



Tirane, 2021



## PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT
2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI
3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE MJEDIS
4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME



## **HYRJE**

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktojne probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

## **BAZA LIGJORE**

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*



## 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

### ➤ Profili i propozuesit

Shoqeria "Bena-Gas" sh.a me administrator Z.Napolon Dede, ka vendndodhjen ne Rugen "Cerkovine", Komuna Novosele, Vlore. Shoqeria zhvillon aktivitetin "Stacion i depozitimit dhe tregtimit te GLN". Siperfaqja e truallit eshte 3250 m<sup>2</sup> dhe siperfaqja e mbuluar e ndertimit eshte 80 m<sup>2</sup>. Shoqeria eshte e pajisur me leje mjedisore Nr. 8279 Prot., date 31.07.2014 per aktivitetin "Stacion i depozitimit dhe tregtimit te GLN". Ne baze te ndryshimeve ligjore subjekti Bena-Gas do te bej aplikimin per Leje te re mjedisore tipi B.



### ✚ PERSHKRIMI I SUBJEKTIT

Shoqeria "Bena-Gaz" e ushtron aktivitetin e tij ne Rruga "Cerkovine", Komuna Novosele, Qarku Vlore.

#### Fuqia punëtore

Ne stacionin e tregtimit te shoqerise "Bena-Gas" sh.a, punonjesit jane ne profesionet teknolog, mekanik, manovrator dhe punetorit te thjeshte. Për të krijuar kushte pune optimale dhe komforte, shoqeria "Bena-Gas" sh.a ka pajisur të gjithë punonjësit me uniformë pune dhe me mjete mbrojtëse.

#### Procesi Teknologjik

Pika e karburantit, e propozuar per tu pajisur me Leje Mjedisore te Tipit B, Kodi III.1.A, ushtron aktivitetin ne nje nga zonat ku ka edhe nje fluks te madh makinash sepse ndodhet buze rruges. Shoqeria ka instaluar 7 depozita me gaz dhe 1 me uje per perballimin e emergjencave:

Pika e karburantit ka keto pjese kryesore:

- Rezervuari nentokesor.
- Ndertesa e pikes se tregtimit ku jane vendosur edhe zyrat si dhe ambiente te tjera sherbimi
- Bazamenti i pompes se bashku me pompen
- Depozitat me gaz
- Depozita me uje



- Mbrojtesit kundra zjarrit  
Per instalimin e pompes perdoret bazament prej betoni, duke e vendosur pompen pikerisht mbi kete bazament, per nje funksionim normal gjate punes.

### ***Çisterna***

Çisterna pergatitet prej nje llamarine çeliku dhe formohet me ane te saldimit. Forma e saj eshte standarte (cilindrike). Spesori i llamarines eshte i trashe, duke garantuar ne kete menyre nje perdorim dhe jetegjatesi te saj pa krijuar probleme teknike, apo avari te ndryshme gjate funksionimit te pikes se tregtimit, si per ruajtje ashtu edhe per siguri. Ajo eshte e pajisur me kapak, ne forme rrethore qe lidhet me korpusin e rezervuarit (trupin), me bulona. Nepermjet ketij kapaku do behet e mundur kontrolli periodik i tyre.

Depozita eshte pajisur me sistem ajrimi dhe lidhet me distributorin me ane te tubacioneve. Çisterna do te lyhet nga jashte me nje material antikorroziv dhe do te vishet me material hidroizolues, per te qene e mbrojtur ne kete menyre nga korrozioni qe mund te shkaktohet nga faktore te ndryshem. Depozita ka nje sistem te detyrueshem tokezimi ne menyre qe te mbrohet ne raste te lidhjeve te shkurtra elektrike dhe ne raste shkarkimesh atmosferike.

### ***Tubacioni***

Tubacioni eshte prej materialeve qe nuk oksidohen nga agjentet atmosferike dhe konkretisht tuba prej materiali xingato.

### ***Furnizimi***

Furnizimi i çisternes do te behet me autobote te specializuara per kete qellim, te cilat e shkarkojne lengun nepermjet kapakut me ane te nje tubi fleksibel drejt e ne depozite.

Ky lloj furnizimi nuk krijon rrjedhje te karburanteve ne mjedisin perreth duke vepruar ne kete menyre, shkarkimi i karburanteve nga autoboti ne depozite behet me nje sistem te mbyllur dhe qe do te kontrollohet gjate gjithë kohes së shkarkimit ne menyre te kujdesshme, per te mos lejuar shkarkimin e karburanteve ne toke.

### ***Pompa***

Ne kete pike tregtimi jane pompa. Instalimi dhe funksionimi i pompave te pikes se tregtimit behet ne baze te projektit teknik per te realizuar kushtet e punes. Pompat se bashku me aksesoret e tjere si tubat, pistoletat jane te instaluara ne menyre te tille qe nuk lejojne rrjedhjen e karburantit, si dhe te pajisura me valvola moskthimi, pajisje kjo e instaluar ne thithjen e linjes se pompes. Pistoleta funksionon me valvol te dyfishte ( me presionin e pompes dhe me dore). Pompat jane te mbuluar me karkase metalike qe e mbron nga renia e lageshtires dhe ujerave gjate proceseve te ndryshme te punes.

### ***Elektromotorri i pompes***

Elektromotorri i pompes eshte hermetik per te evituar ne kete menyre difektet e ndryshme qe mund te rezultojne nga faktore te jashtem ose te brendshem qe mund ta demtojne ate.



### *Instalimet elektrike*

Instalimet elektrike do te behen ne menyre hermetike qe te mos lejojne futjen e avujve apo karburanteve te lenget ne sistem qe mund te shkaktoje zjarr.

## **2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

### **Pozita gjeografike**

Vlora është një qytet bregdetar në jugperëndim të Shqipërisë. Vlora është qyteti i dytë më i madh portual pas Durrësit. Ndodhet në jugperëndim të Shqipërisë, në Detin Adriatik dhe është qendra e Rrethit të Vlorës dhe të Qarkun së Vlorës. Është qyteti ku është shpallur Deklarata e Pavarësisë shqiptare më 28 nëntor 1912. Themeluar si një koloni e lashtë greke në shekullin e 6 pes me emrin Aulona dhe vazhdimisht i banuar për rreth 26 shekuj, Vlorë është shtëpi për Portin e Vlorës dhe Universitetin e Vlorës si qyteti më i rëndësishëm ekonomik dhe kulturor i Shqipërisë jugperëndimore.

### **Kushtet klimatike**

Gjiri i Vlores shquhet per nje klime mesdhetare teper te volitshme, ku bashkejeton klima detare me ate malore, freskia e detit me boren ne lartesine e maleve. Deti me ndikimin e tij ne klime e mikroklime te zones perreth nuk lejon ditet me vape te padurueshme ne vere apo uljen e tejskajshme te temperatures ne dimer. Temperatura mesatare e muajit me te ftohte (janarit) nuk ulet me poshte se -9°C, temperatura mesatare e muaji me te nxehte, korrik, arrin ne 34°C. shpejtesia maksimale e eres arrin ne 45m/sek. Zgjatja faktike e diellezimit eshte 2741 ore ne vit, me vlere nga 111 ore ne dhjetor dhe 375 ore ne korrik. Mesatarisht regjistrohen 125 dite te kthjelleta dhe 77 dite me vranesi.

#### ***Vlora ne 4 stine***

Pranvera, pa padyshim eshte momenti me i bukur per Vloren. Ajo mbushet me aromat e kendshme te luleve shumellojshe qe e gjallerojne ate: mimozat fillojne te celin qe nga mesi apo fundi i shkurtit pasi klima e bute e favorizon kete. Festat e pranveres si: pashket, bajrami apo karnavalet e Nartes, festohen plot ngjyra ne mjediset e gjelbra.

Vera eshte triumfi i detit, i shetitjes me barka me vela apo i windsurf-it. Brenda qytetit i nxehti eshte i ndjeshem, por ne mjediset me te larta mund te programohet nje pushim i fresket. Muajt e vjeshtes jane periudha e zbehjes dhe fillimi i dimrit me shira apo te ftohte, rralle here i shoqeruar me rreshje debore. Llogaraja 1026 m mbi nivelin e detit, pwr stinwn e dimrit eshte me e frekuentura.

#### **Pranvera**

Mbi kodrat, barinjte e gjedhet fillojne te spostohen drejt kullotave me te larta, te mbushura me bar, terfil e trendeline. Delet me qingjat e vegjel krijojne pamje te paharrueshme per kedo duke te futur ne gjirin e natyres. Ne periudhen e lulezimit bletet mbledhin nektarin e luleve plot arome dhe rezultati do te jete mjalti tradicional me cilesi te jashtezakonshme qe shoqeron dhe embelsirat tradicionale.

#### **Vera**



Brigjet e Vlores jane te mbushura me pushues nga vendi, apo te huaj, zhytes qe eksplorojne faunen nenujore joniane. Barkat me vela shetisin pushuesit drejt mrekullive natyrore te Karaburunit. Mbremjet shoqerohen nga muzike live folkloristike dhene pergjate brigjeve te detit per pushuesit, kengetaret me te mire vendas jane te ftuar cdo jave ne ambientet e ndryshme qe ju ofrojne argetim dhe relax.

### **Vjeshta**

Ne shtator klima e ngrohte lejon ende banja deti te kenaqshme, por ne mbremje temperatura ulet. Vreshtaria tashme ka rezultatet e veta: vera dhe rakia jane pijet e perfituara me menyren tradicionale duke ruajtur ne menyren me te mire natyrshmerine e tyre. Ne tetor dhe nentor eshte koha e zbehjes, jane shirat qe mbizoterojne dhe qielli gri. Festa e flamurit, 28 nentori i shoqeruar nga manifestime e celebrime qe nisin me ngritjen e Flamurit ne Sheshin e Flamurit, i sjellin gjallerine qytetit.

### **Dimri**

Te ftohtet bejne largimin e gjedheve dhe kafsheve te tjera ne stallat e tyre dimerore dhe peshkimi ne brigje pakesohet si pasoje e ererave te forta. Festat e fund vitit jane ato qe e gjallerojne jeten dimerore. Viti i ri festohet ne shtepi me pergatitjen e embelsirave tradicionale si bakllavaja, shendetlija, etj. Llogoraja e mbuluar me debore krijon mundesine e nje shetitjeje ditore duke shijuar pamje nga me mahniteset: pisha te gjelbra e te bardha, livadhe te mbuluar me debore per lojera te ndryshme do ta benin me terheqes kete udhetim.

### **Toka, flora, fauna**

Fushat, livadhet dhe pyjet e Vlores ofrojne mjedise te favorshme per rritjen e bimeve dhe kafsheve te ndryshme. Zona e Vlores kultivon bime te ndryshme bujqesore si perime, drithera, kultura foragjere etj. Vlora kultivon druret frutore te zones se Mesdheut si: agrumet (portokallet, limonat, mandarinat) dhe ullinjte. Vreshtaria ze vend paresor.

Bimet barishtore dhe eterovajore qe sherbejne ne mjekesine popullore dhe farmaceutike shtrihen nga zona fushore e deri ne ate malore.

Ne zonen e shkurreve rritet valanidhi dhe perralli, te njohur per vlerat kurative.

Ne lartesine 800 m mbi nivelin e detit, shtrihet zona e dushkut (nga qafa e Mazharit deri ne Bristan)

Mbi 800 m mbi nivelin e detit gjendet zona e pishave dhe bredhit (dendur ne Llogora) si dhe bushi e shtogu.

Kullotat subalpine gjenden ne lartesine 700-1800m ne Vastak, ne majen e Cikes dhe malet e Rimit.

Fauna dhe eritrofauna eshte e pasur ne lloje ne gjithe zonen: sorkadhja, derri i eger, ujku, cakalli dhelpira, lepu i eger (sidomos ne pyllin e Llogorait), eritrofauna e pasur si ne toke ashtu edhe ne ujera: qukapiku, harabeli, mellenja, laraska, zhgaba, skifteri, petruti, thellezat, pellumbat e eger, shapkat (liqeni i Orikumit). Jo rralle shfaqen dhe delfinet e Mesdheut.

Zona e Vlores pret te pakten 33 lloje qe meritojne mbrojtje prej te cileve 14 te vleresuar si te rrezikuara per t'u zhdukur, si foka murgeshe mesdhetare (Monachus Monachus), breshka (Caretta Caretta), tritoni i kreshperuar (Triturus Cristatus) pelikani me krrela (Pelecanus Crispus), shqipja me bllama (Aquila clanga).

Laguna e Nartes eshte zone me rendesi nderkombetare me nje numer zogjsh ujore me teper se 48.700 individe. Ne dimer me shume se 23% e gjithe zogjve ujore te Shqiperise strehohen ketu. Kurse laguna e Orikumit dallohet kryesisht per rosat.



### **3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

- **Ndikimet në toke**

Nga zhvillimi i aktivitetit nuk ka aplikohen norma shkarkimi në toke, sic mund të jenë ndryshime në topografinë lokale, erozionin e tokës apo ndryshime të tjera të dukshme. Nuk do të ketë emetime kimike apo depozitime në tokë në vendin ku do të zhvillohet aktiviteti ose rreth zonës përreth pasi mjetet që do të transportojnë lëndet do të jenë të pastra dhe me kushte të rregullta teknike. Sipërfaqja e vendi ku zbatohet ky aktivitet përjashtojnë në mënyrë kategorike ndikimin në cilësi dhe sasi të tokës bujqësore për vetë faktin se nuk zbatohet në tokë bujqësore, po në një ish ndermarrje kimike dhe në një zonë industriale, e papershtatshme për prodhimet bujqësore.

- **Ndikimet mbi popullsinë**

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka ndikime negative mbi popullsinë përreth, përveçse zhvillimi i këtij aktiviteti do të sjellë punësimin e disa baroreve përreth duke kontribuar sadopak në rritjen e mirëqenies në zonë.

- **Ndikimet në cilësinë e ajrit**

Emetime në ajër nga funksionimi i këtij aktiviteti nuk do të jenë shqetësuese dhe në nivele të larta. Kryesisht do të kemi emetime vetëm nga mjetet e transportit të cilat janë në norma të ulëta sepse janë në kushte shumë të mira teknike.

- **Ndikimet në ujë**

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk shkaktohet ndotje e ujerave nëntokësore apo në ujrat sipërfaqësore. Duke iu referuar natyrës së aktivitetit nuk kemi shkarkime me karakter ndotes. Të vetmet shkarkime do të jenë ato të ujerave higjienosanitar të tualeteve të cilat do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve të zonës.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Duke qenë se aktiviteti ndodhet në largësi të konsiderueshme nga zonat e banuara dhe bizneset atëherë zhurmat nuk përbejnë shqetësim për komunitetin. Gjithashtu zhurmat që gjenerohen nga mjetet e transportit janë në nivele të ulëta sepse mjeteve u është bërë koalidimi dhe kontrolli i nevojshëm, ato janë në gjendje shumë të mira teknike. Zhurmat që do të gjenerohen nga procesi i punës, janë brenda normave të lejuara për mjedise pune.

- **Mbetjet e prodhuara**

Mbetjet e vetme që do të prodhohen janë ato urbane të cilat do të grumbullohen në kosha të vecante brenda territorit të subjektit me pas do të depozitohen në vendin e përcaktuar nga NJ.Q.V.





- **Ndikimet ne flore dhe ne faune**

Duke iu referuar natyres se aktivitetit nuk kemi ndikime negative ne flore edhe faune. Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk i prek as ne menyre te drejteperdrejte as ne menyre te terthorte.

### **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

**Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte:**

Atje ku jane identifikuar ndikime negative te dukshme, te pershkruhen masat qe do te merren per te menjanuar, zvogeluar ose ndrequr keto ndikime, si psh:

Planifikimi i zones;

Masat teknike, psh: procesi selektiv; riciklimi; trajtimi dhe kontrolli i ndotjes.

Masat estetike dhe ekologjike, si psh. modeli, ngjyra, etj: pejsazhimi; mbjellja me peme.

Masat per te ruajtur habitatet ose per te krijuar habitate alternative.

Regjistrimi i zonave arkeologjike.

Masat per te ruajtur zona ose ndertime historike.

#### **Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese.**

Gjate zbatimit te projektit bazuar ne masat zbutese te pershkruara me siper "stacioni i depozitimit dhe tregtimin GLN" eshte brenda parametrave te percaktuara. Per shmangie aksidentale eshte perpiluar nje plan emergjence i cili nuk do lejoje rrjedhje te padeshirueshme lendesh te demshme.

#### **Rregjimi i punës**

Rregjimi i punës dhe koha e punës se makinerive dhe paisjeve në zbatimin e projektit është 8 ore. Me këtë rregjim pune përballohen të gjitha planifikimet e projektit. Nuk do kete punime gjate nates te cilat mund te shkaktonin shqetesime per komunitetin.

#### **Sigurimi teknik , Mbrojtja ne pune, Mbrojtja nga zjarri**

Gjate fazes se punimit dhe trajtimit te mbetjeve portuale jane te detyrueshme zbatimi i rregulloreve te sigurimit teknik ne pune dhe rregulloret e mbrojtjes nga zjarri.

#### **Punedhenesi ka detyre:**

- ✓ Te kualifikoje punonjesit, per teknologjine ne perdorim, proceset e punes dhe kerkesat teknike qe duhet te zbatohen.
- ✓ Te pranoje ne pune persona te afte nga ana shendetesore dhe mendore qe e verteton me raport mjeksor.
- ✓ Ti instruktoje punonjesit per proceset e punes qe do te kryejne.
- ✓ Ti njoh me rregulloret e sigurimit teknik ne fuqi.
- ✓ Ti njoh me rregulloren e mbrojtjes nga eksplozioni
- ✓ Ti njoh me rregulloren e mbrojtjes nga zjarri.
- ✓ Tju beje te ditur shkaqet e aksidenteve dhe masat qe duhet te merren per ti menjanuar ato.



- ✓ Te kualifikoje punonjesit per te qene te afte te japin ndihmen e shpejte ne raste aksidentesh.
- ✓ Te siguroje mjetet mbrojtese individuale dhe kolektive per punonjesit.
- ✓ Te monitoroje nivelin e sigurise ne pune.

#### **Punemarresi ka detyre:**

- ✓ Te kualifikohet per procesin e punes qe do te kryeje.
- ✓ Te zbatoje rregulloret e sigurimit teknik ne pune.
- ✓ Te perdore mjete individuale mbrojtese ne pune.
- ✓ Te mos lejoje qe punen e tij ta kryeje nje punonjes tjetër.
- ✓ Kur konstaton avari, merr masa per ta eliminuar ate dhe njofton menjehere drejtuesin teknik.
- ✓ Te jap ndihmen e shpejte shokut ne raste demtimi.
- ✓ Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- ✓ Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjes ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt fillon punen.
- ✓ Kur nuk ndihet mire me shendet ve ne dijeni pergjegjesin dhe largohet nga fronti punes.

#### **Mbrojtja nga zjarri**

Per tu mbrojtur nga zjarri ne projekt jane vendosur mjete te ndryshme si depozita uji dhe zjarrfikese te levizshme.

